Wilson Center Digital Archive
International History Declassified
digitalarchive.wilsoncenter.org

# October 26, 1964

# Report on the meeting between the Democratic Republic of Vietnam's representative Tran Dinh Thu with Shpresa Fuga on October 26, 1964

## Citation:

"Report on the meeting between the Democratic Republic of Vietnam's representative Tran Dinh Thu with Shpresa Fuga on October 26, 1964", October 26, 1964, Wilson Center Digital Archive, AMPJSh, V. 1964, D 256, p. 36
https://wilson-center-digital-archive.dvincitest.com/document/112198

## Summary:

This document is a report on a meeting between the Democratic Republic of Vietnam's representative, Tran Dinh Thu, with an Albanian official, Shpresa Fuga. Tran Dinh Thu discusses an upcoming international conference on solidarity with the people of South Vietnam against the Americans that is to be held in Hanoi on November 25. He invites the Albanian delegation along with 50 other delegations. The conference and the idea behind it are initiated by the Committee of the Communist Party of North Vietnam, but in fact it is carried out by the Vietnam Committee of Peace, the Afro-Asian Solidarity Committee and the National Front of Vietnam.

## Original Language:

Albanian

## Contents:

- Original Scan

Wilson Center Digital Archive Original Scan

J ARK
sjF Fe

I DEKLASIFIKUAR

Vietnami 1964
D-III/4

BII-3

36

MPJ ARKIVI
Viti:
Dosja:
Fleta:

# Informasion

**Mbi takimin me sekretarin e pare te Ambasades se RD te Vietnamit Tran Dinh Thuy:**

1)Ne takimin e bere me 26 tetor 1964 sekretari i Ambasades vietnameze informoi lidhur me gjendjen e krijuar ne Vietnamin e Jugut dhe sidomos te raprezaljeve te bera atje nga imperialistet amerikane dhe klika sunduse e vendit kohet e fundit.Ne grupin e arrestuar kohet e fundit perfshihet edhe shoku Le Hon Te,komunist dhe qe kam marre pjese ose me mire ka qene koka drejtuse e levizjes se Le Hon Veit.Qeverija kukull ka vendosur te pushkatoje te arrestuarit duke perfshire dhe shokun Le Hon Te.Me kete mase ata kane per qellim te bejne presion rinise dhe nga ana tjeter te kenaqin deshirat e amerikaneve.

Sekretari vuri ne dukje se fronti nacional-çlirimtar i Vietnamit te Jugut ka bere nji deklarate lidhur me vendimin e siperme dhe se edhe ne Vietnamin e Veriut jane bere deklarata solidariteti.Shoket vietnameze ,duke marre parasysh edhe personalitetin e Le Hon Te-se,komunist, luten qe vendet miq ta ngrene kete çeshtje ne shtypin e tyre per te ngjallur emocion kunder masakrave.Duke falenderuar per perkrahjen tone te vazhdueshme, u lut qe shtypi i yne ta ngreje kete çeshtje.

2)Komiteti vietnamez i paqes,Komiteti ~~vietnamez~~ i solidaritetit afro-aziatik dhe fronti kombetar i Vietnamit, kane vendosur qe te therresin nje konference nderkombetare per solidaritetin me popullin vietnamez kunder imperializmit dhe per paqen boterore, me 25 nendor ne Hanoi.Per dijenine tone ay informoi se konferencen ne fakt ka vendosur ta therrese Komiteti Qendror i PP te vietnamit, i cili kohet e fundit vleresoi gjendjen nderkombetare dhe ate te brendeshme ne Vietnam dhe e konsideroi oportune mbajtjen e nji konference te tille e cila do te demaskoje akoma me shume imperialistet dhe revizionistet te cilet gjithmone po pesojne disfata te njimbas njishme.Ketu ay vuri ne dukje disfatat ne agresionin kunder veriut,qendrimin e revizionisteve ne konferencen e Tokios dhe ate te Kajros(dhe ketu cilesoi Titon)heqjen e Hrushovit etj.dhe vuri ne dukje fitoret

%

Me 3/XI ... [illegible handwritten margin note] ... Rinija.
[signature] 3/XI/64

Wilson Center Digital Archive Original Scan


e forcave revolucionare duke permendur ketu dhe fitoren e RP te Kines.

Lidhur me konferencen e siperme ata kane ftuar 50 delegacione nga vende ose organizata te ndryshme dhe mendojne se do te kete rreth 100 pjesemarres duke mos perfshire ketu ata te vietnamit te veriut dhe te jugut.Delegacionet do te jene nga vendet e azise dhe te afrikes,nga vendet e amerikes latine, nga vend t socialiste,nga organizatat ~~xxxx~~ demokratike nderkombetare, do te kete personalitete te ndryshme etj.Ne kete konferen ce ftojne dhe nji ~~xxxxxxx~~ perfaqesues nga vendi i yne dhe ne te njejten kohe u lut qe konferenca te mbeshtetet nga ana e jone.Deri tani tha ay, konferenca nuk eshte shpallur porse jane duke u bere pregatitjet.

Ne konference do te paraqiten raporte nga delegatet e vietnamit te veriut dhe ata te jugut.Do te mbajne gjithashtu fjalime delegacionet e tjera.Mbledhja do te shprehet kunder akteve agresive te imperialisteve amerikane ndaj vendeve qe do te kete ose jo ne mbledhjen e siperme delegacione.Mbledhja do te aprovoje gjithashtu vendime te ndryshme.

Duke theksuar ndihmen tone ne organizata te ndryshme nderkombetare, ay shprehu besimin per ndihmen tone edhe ne te ardhmen duke vene ne dukje se ata besimin dhe mbeshtetjen e kane tek neve, tek shoket kineze dhe tek koreanet.Ne keto kushte, ay u lut qe delegati i yne te jete atje te shumten me 21 nendor mbasi ~~xxxx~~ do te kene nevojen e konsultimit dhe te pere caktimit te mbajtjes se qendrimeve te perbashketa.Delegacionet tona tha ay, do te perbejne berthamen e konferences.

2)U lut edhe nji here qe ti ipen nga ana e jone hollesira lidhur me hapjen e ambasades tone ne Hanoi, personelin, nevojat qe do te kene etj. duke marre parasysh se shoket tone do te vene ne pragun e festes sone dhe se shoket vietnameze duan te krijojne tere lehtesirat e mundeshme.Ne tha ay jemi te detyruar shume ndaj shokeve shqiptare per gjithcka.

Theksova qendrimin tone dhe mbeshtetjen luftes se tyre, falenderova per ftesen lidhur me konferencen dhe per kujdesin per ambasaden tone dhe se per te gjitha do te vej ne dijeni ~~xx~~ shoket dhe do i pergjigjem.

Tirane me 26 tetor 1964. Shpresa Ekra